



Sufizmi dhe Sheriati

Description

Shafik ur-Rahman

Të gjitha falenderimet i takojnë Allahut. Ne i lutemi Atij, kërkojmë ndihmë prej Tij dhe i kërkojmë Atij falje dhe kërkojmë mbrojtjen tek Allahu nga e keqja në vetet tona dhe nga të vepruarit e gabuar, këdo që Allahu e udhëzon nuk ka kush që ta humbasë e këdo që Allahu e kequdhëzon nuk ka kush ta drejtojë në rrugë të duhur. Dëshmoj që nuk ka hyjni tjetër që meriton të adhurohet përpos Allahut. Ai është i Vetmi, i Pashok dhe i Dëshmoj që Muhamedi është shërbëtori i Tij dhe i dërguari i Tij. E begatoftë Allahu atë, familjen e tij dhe shtetasit e tij. Me të vërtetë që nuk ka fjalë më të mirë se sa fjala e Allahut (Kurani) dhe nuk ka udhëzim më të mirë se ai i profetit Muhamed (a.s). Përmes kësaj lutjeje kërkoj që vëmendjen time ta drejtoj nga Tesaufi – një nga shokët dhe shkencës islame që në të shumtat e rasteve është e keqkuptuar e kjo për shkak të panjohurisë ndaj saj. Në lloj diskutimi apo komenti për sa i përket Tesaufut duhet të mbështet në thënie apo në përfundimet e dijetarëve në kësaj fushe. Tasaufi është një nga shkencat e shumta të Islamit (*ulum*) sikundër shumica e disiplinave të Islamit janë zhvilluar pas vdekjes së Profetit (a.s), si e tillë, por kjo nuk e zhvlerëson atë duke ekzistuar në mënyrë legjitime. Ka shumë shkencë Islame që morën formën e përfundimit pas vdekjes së Profetit. Siç janë: Jurispundenca Islame (*usul Fikh*), metodologjia e hadithit (*ulum el-hadith*). Ndërkohë që në vetvete shkenca e Tesaufit është plotësisht Islame, duke dashur të nxjerrë si përfundim këtë pikë do të mbështetem, me lejën e Zotit, në riprodhimin sa më besnik të thënieve të dijetarëve të ndryshëm për sa i përket Tesaufit.

Do ta filloj përshkrimin e Tesaufit me citimin e një punimi të kohëve të fundit dhe bëhet fjalë për *The Oxford Encyclopaedia of the Modern Islamic World*, edituar nga Profesor John L. Esposito, Oxford University Press, Oxford, Maj 1995, 4 vëll.: “në një kuptim më të thellë, Sufizmi mund të përshkruhet si një thellim apo intensifikim i besimit dhe praktikave Islame. Kuptimi i fjalëve për fjalshëm i Sufizmit është ‘të veshurit me një robë prej leshi’. Gjatë shekullit të tetë fjala mori një kuptim atribues ndaj atyre muslimanëve që asketizmi i dërgonte në atë gjendje sa të visheshin me rroba të leshta dhe me to të mos ndiheshin në rehati. E më vonë ky grup u diferencua në grupet e tjera përmes një mënyre të ndryshme të shpjeguarit dhe kuptuarit të Kuranit dhe Sunetit profetik. Ndërkohë që në shekullin e nëntë pjesëtarët e këtij grupi morën emrin Sufistë ndërsa veprimet e tyre morën emrin Sufizëm.

E kuptuar si një pjesë integrale dhe e rëndësishme e Islamit, sufizmi ka bashkë ekzistuar me të. Në çdo vend ku që kemi patur Islam kanë ekzistuar dhe sufistë. Nëse në kohën e Profetit nuk kanë ekzistuar sufistët apo sufizmi po ashtu nuk kanë ekzistuar as “fikhu” apo “kelami” në formën që ne sot i njohim ato. Këto janë emra të cilat ju vendosën këtyre shkencave në kohën kur tradita filloj të ndahej dhe të studiohej. Ndërkohë që për sa i përket kërkimit të një emri apo emërtimi në Kuran të sufizmit, disa autorë janë të mendimit se ihsan (‘të kryesh dhe mirëbukur’) është termi që i përshtatet më shumë, një cilësi hyjnore po aq sa edhe njerëzore e cila përmendet në Kuran si një vepër e mirë dhe një vepër që ato që e posedojnë Zoti i do. Në hadithin e famshëm të Gabrielit Profeti i përshkruan atij ihsanin si dimensionin e brëndshëm të Islamit, e ky dimension vjen pas Islamit (që është nënshtrimi ndaj Zotit) dhe Imanit (“besimi” ose më saktë të kuptuarit e saktë).” [vol. 4, fq. 102-104.]

Lidhja mes Ihsanit dhe Tesaufit ndodhet dhe tek perkthimi në Anglisht të Sahihut të Muslimit nga Abdul Hamid Sidiki në një shënim në fund të faqes ku ndodhet hadithi: “**Ihsani** do të thotë mirësi, kryerje e veprave të mirë por në kontekstin religjioz ai përfshin të vepruarit mirë madje edhe kur nuk është e drejtë një sjellje e mirë për ato çaste. Është një tregues i përkushtueshmërisë së njeriut ndaj Krijuesit dhe Zotëriut të tij duke mëshiruar dhe kryer vepra të mira. Ajo çka kuptohet me termin Tesauf në Islam nuk është gjë tjetër veçse Ihsani. Që Ihsanit është që të krijohet një ndjesi mëshire dhe sensibiliteti të njeriut brënda tij dhe e gjithçka që vepron në të bëhet nga dashuria për Zotin.” [vol. 1, pp. 3-4.]

Në veprën e tij, *The Cultural Atlas of Islam*, Macmillan Publishing Co., New York, 1986, Prof. Ismail R. Faruki, një dijetar i këtyre viteve dhe aktivist në përhapjen e Islamit, i ka kushtuar një kapitull më vete Sufizmit. Në hyrje të kapitullit pohohet se: “*Tesaufi*, ose të veshurit me një robë prej leshi, përfshin emërtimin e një lëvizjeje që dominoj zemrat dhe mendjet e muslimanëve për më tepër se një mijëvjeçar dhe sot e kësaj dite është shumë e fuqishme në disa vende të botës muslimane. Ai e ndriçon shpirtin, pastron zemrën dhe e përmbush atë me mëshirë, drejtësi dhe virtut e dëshiron të afrojë zemrën e njeriut me Zotin. Ajo u ngrit dhe zhvilloj mjaft shpejt në çdo skaj të botës muslimane dhe është një ndër shkaqet për konvertimin e shumë personave në Islam në vende të ndryshme.” [fq. 295]

Në veprën e tij, *The Concise Encyclopedia of Islam*, Hamar Collins, New York, 1986, përkthim

Shënime

[i] Me dije të shenjtë do të kuptojmë dijet Islame si Fikhu, Kelami, Akide dije përmes të cilave njerëzit afrohen me Krijuesin. (sh.p)

[ii] Këtu bëhet fjalë për pastërtinë fetare p.sh abdesi (sh.p)

[iii] Këtu bëhet fjalë për faljen e këtij namazi pas faljes së namazit të Akshamit (sh.p)

[iv] Këtu bëhet fjalë për Kelamin (sh.p)

[v] Shpëtimi i Shpirtave dhe Përkushtimi Islam (sh.p)

[vi] Këtu nuk bëhet fjalë për një Shpallje sikurse është shpallja e Kuranit (sh.p)

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi